

VENDIM
Nr.520, datë 12.12.1992

PËR MBULIMIN ME FONDE VALUTORE TË QYMYREVE QË DO TË IMPORTOHEN
PËR NGROHJE TË POPULLSISË

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit i shtohene 1 milion USD nga kredia austriake për mbulimin me fonde valutore të qymyreve të kontraktuara për ngrohjen e popullsisë në dimrin e viteve 1992-1993.

2. Ngarkohet Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike për të kaluar 0.3 milionë USD, të papërdorura nga kontratat e qymyreve të vitit të kaluar, në favor të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

3. Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të marrë masa për ardhjen në kohë të qymyreve të kontraktuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi